

25 Shtator 2014, Prishtinë

## KOMUNIKATË PËR MEDIA

### Problemet rreth punimeve në Hamamin e Madh të Prishtinës nuk kanë të ndalur

Në kuadër të projektit “Online Transparency”, EC Ma Ndryshe gjatë muajve qershor- shtator ka filluar një hulumtim rreth punëve konservuese dhe restauruese në ndërtesat e trashëgimisë kulturore në Prishtinë. Pas konstatimit të problemeve të shumta që po i përcjellin Xhaminë e Çarshisë dhe atë të Jashar Pashës, hulumtimi vazhdon me punët konservuese në Hamamin e Madh të Prishtinës.

Angazhimi rreth restaurimit të Hamamit të Madh në Prishtinë filloi qysh në vitin 2006, me ç’rast organizata CHwB (Trashëgimia Kulturore pa Kufij) dhe Komuna e Prishtinës nënshkruan një Memorandum Mirëkuptimi. Pjesë e marrëveshjes ishte edhe formimi i një Bordi të Projektit, me përbërje nga Komuna, CHwB, IMMK (Instituti për Mbrojtjen e Monumenteve të Kosovës) dhe Fakulteti i Ndërtimtarisë dhe Arkitekturës. Këtij bordi iu ngarkua detyra e hartimit të programit të restaurimit të Hamamit të Madh.

Në vitet 2007 – 2008, CHwB mori përsipër realizimin e një pjese të fazës së parë të projektit që përfshinte pastrimin e Hamamit dhe mbulimin e përkohshëm, kurse Komuna financoi konsolidimin emergjent të objektit.

Pas kësaj faze, nën financimin e CHwB-së, filloi hartimi i planit të konservimit dhe restaurimit të Hamamit, nga ark. Mustafa Pehlivanoglu nga Turqia, ndërsa mbikëqyrja e hartimit të planit iu besua ekspertës ark. Zeynep Ahunbay. Krahas Bordit të Projektit u formua edhe Bordi i Ekspertëve, të cilët kishin për detyrë këshillimin profesional në lidhje me projektin. Në vitin 2009, pas finalizimit, plani i konservimit u miratua nga Bordi i Projektit si dhe nga IMMK-ja, e cila njëkohësisht ishte edhe mbikëqyrëse e realizimit të projektit.

Faza e dytë e projektit filloi në vitin 2009 dhe parashihte konsolidim e kupolave të Hamamit. Për këtë fazë u ndanë gjithsej rreth 300.000 euro, prej të cilave 50.000 euro u ndanë nga MKRS-ja, ndërsa pjesën tjetër e ka ndarë Komuna. Mirëpo, me fillimin e zbatimit të fazës së dytë filluan edhe problemet në Hamam. Shumë prej palëve të përfshira në projekt shprehën pakënaqësi lidhur me mënyrën e zbatimit të projektit. Atë kohë u shpërbë edhe Bordi i Ekspertëve.

Pakënaqësia e parë kishte të bënte me kompaninë e kontraktuar për implementimin e punëve të planit të restaurimit. Sipas CHwB-së, kompania e përzgjedhur nga Komuna nuk kishte përvojën e duhur në punët konservuese. Kompania fituese kishte angazhuar ekspertë nga IMMK-ja për realizimin e punëve, ndërsa në të njëjtën kohë IMMK ishte e angazhuar edhe në mbikëqyrjen e projektit.

Krahas kësaj, shqetësim kryesor ishte se punimet në terren kishin devijuar nga plani i restaurimit, si pasojë e mungesës së mbikëqyrjes adekuate nga IMMK-ja dhe Komuna. Nuk merreshin parasysh as sugjerimet e Bordit të Ekspertëve pas vizitave të shumta që i bëheshin ndërtesës. Shqetësimet rreth devijimit të planit i kishte konfirmuar edhe autori i projektit, ark. Mustafa Pehlivanoglu, i cili kishte kërkuar që urgjentisht të ndaleshin punimet dhe të bëhej vlerësimi i dëmit të shkaktuar në ndërtesë.

Reagim të ashpër kishte shprehur edhe koordinatori i projektit, ark. Zeynep Ahunbay, përmes një raporti, në të cilin i kishte numëruar devijimet që ishin bërë në objekt. Edhe ambasadori i atëhershëm i OSBE-së në Kosovë i kishte bërë thirrje Komunës për ndërprerjen e punimeve në Hamam.

Mirëpo, pavarësisht kritikave të shumta, restaurimi i Hamamit vazhdoi deri më 7 shkurt të vitit 2013, kur MKRS-ja mori vendim për ndërprerjen e punimeve. Ky vendim erdhi pas konstatimit nga Komisioni për Vlerësimin e Kërkesave – Projekteve Restauruese/Konservuese të Trashëgimisë Kulturore se punimet në Hamam po realizoheshin në kundërshtim me Ligjin për Trashëgimi Kulturore dhe në kundërshtim me normat profesionale për restaurim dhe konservim.

MKRS angazhoi një eksperte nga Tirana për ekzaminim e llaçit të vendosur në muret e brendshme. Pas pranimit të rezultateve, MKRS mori vendim për heqjen e llaçit të vendosur dhe vendosjen e llaçit tjetër, duke respektuar recepturën adekuate. Sipas këtij vendimi, mbikëqyrja e vazhdimit të punimeve duhet të bëhej nga një ekspert i QRTK-së (ish- IMMK) së Prishtinës.

Këshilli i Kosovës për Trashëgimi Kulturore kishte analizuar, në fillim të vitit 2013, punimet në Hamam, duke përgatitur një raport rreth gjendjes shqetësuese të punimeve, të cilën ia kishte dërguar MKRS-së. KKTK, ndër të tjera, kishte vlerësuar se monumentit i është cenuar integriteti dhe autenticiteti, si pasojë e ndërhyrjeve joprofesionale përgjatë viteve 2009-2013.

Faza e tretë e punimeve, përveç konsolidimit të mureve të brendshme dhe të jashtme, punimet të kulmit në pjesën e shatërvanit, e suvatimit dhe gëlqerosjes, përfshinte edhe shtrirjen e kabllave elektrike. Punimet e kësaj faze vazhduan deri në fillim të këtij viti, kur, për shkak të mos eliminimit të lagështisë nëpër mure kishte filluar të bjerë llaçi nga muret e jashtme. Kështu, pas vizitës në terren nga ana e MKRS-së, Drejtorisë së Kulturës dhe Drejtorisë së Urbanizmit, Komuna e Prishtinës kishte kërkuar nga MKRS-ja të ndërpriten punimet. Komuna kishte vendosur për formimin e një komisioni vlerësues, me qëllim të rishikimit të punëve të deritanishme të projektit, për të dalë më pas me rekomandimet për vazhdimësinë e punimeve. Sipas drejtoreshës së Departamentit të Trashëgimisë Kulturore në MKRS, znj. Vjollca Aliut, MKRS-ja është në pritje të vendimit të Komunës rreth vazhdimit të punimeve.

Që nga ndërprerja e fundit e punimeve e deri me sot kanë kaluar pothuajse nëntë muaj, ndërsa ende nuk është formuar komisioni për vlerësimin e punimeve nga ana e Komunës.

Duke i marrë parasysh këto, EC Ma Ndryshe rekomandon formimin sa më të shpejtë të këtij komisioni, me qëllim të vlerësimit të punimeve dhe ndërmarrjen e masave të nevojshme varësisht nga rezultati i vlerësimit.

Në fund fare, EC Ma Ndryshe do të donte të rikujtonte institucionet përgjegjëse komunale dhe shtetërore se në bazë të Ligjit për Trashëgimi Kulturorë (ligji nr. 02/L-88, 2006), neni 4.10. *Secili person juridik dhe fizik ka për detyrë që të kujdeset për mbrojtjen e tërësisë së trashëgimisë kulturore nëse ai/ajo është pronar, posedues ose shfrytëzues i kësaj trashëgimie kulturore.* Së këndejmi, është momenti i fundit që këto institucione të angazhohen bashkërisht dhe me përgjegjësi për të ndërmarrë masa për ndalimin e degradimit serioz që i është bërë tashmë nga intervenimet jo profesionale. Zvarritja e konstituimit të komisionit vlerësues nga ana e Komunës, por edhe mungesa e bashkëpunimit ndërinstytucional në këtë moment mjaft delikat në të cilin gjendet objekti i Hamamit të Madh të Prishtinës (sikurse në rastin e Xhamisë së Çarshisë në Prishtinë), ka për pasojë zvarritjen e procesit restaurues dhe me këtë rrezikon e madh të degradimit të mëtutjeshëm.

Projekti i EC Ma Ndryshe për monitorimin e transparencës së komunës së Prishtinës do të vazhdojë të publikojë të gjeturat e monitorimit përmes komunikatave të rregullta dhe përmes ueb-faqes së projektit, ku të gjeturat postohen drejtpërdrejtë nga monitoruesit. Të gjitha të gjeturat e monitorimit, përfshi komunikatat e rregullta dhe shumë informacione të tjera në lidhje me qeverinë lokale të Prishtinës do të publikohen në ueb-faqen e projektit, [www.online-transparency.org](http://www.online-transparency.org).

Ju faleminderit,

*Erinë Mulolli*, monitoruese  
OJQ EC Ma Ndryshe  
Rr. Saraçët, Nr. 5 – Prizren  
Rr. Perandori Dioklecian 14 Kati V (te Qafa), Prishtinë 10000  
[www.ecmandryshe.org](http://www.ecmandryshe.org) & [info@ecmandryshe.org](mailto:info@ecmandryshe.org)  
+381 38 224 967 & +381 29 222 771  
[erine.mulolli@ecmandryshe.org](mailto:erine.mulolli@ecmandryshe.org)



British Embassy  
Pristina

Pristinë.

*Projekti “Transparenca Online e komunave të Prizrenit, Mamushës dhe Prishtinës” përkrahët financiarisht nga Ambasada e Mbretërisë së Bashkuar në*